Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-470
Datë: 04.08.2023

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.08.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Ri-Akreditohet dhe Ri-Validohet** institucioni Professional Beauty Academy, me adresë Bulevardi Bill Klinton, Lagjia Dardania, Prishtinë për periudhën tri (3) vjeçare, përkatësisht nga data 16.07.2022 deri 15.07.2025, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 **Grimer/Grimere, Niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim i bazuar në standarde kombëtare D me 9 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 10 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për një grup mund të jetë maksimalisht 10 kandidatë.

   1.2 **Manikyrist/Manikyriste, Niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim i bazuar në standarde kombëtare D me 4 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 12 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për një grup mund të jetë maksimalisht 10 kandidatë.

   1.3 **Parukier/Parukiere Niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim i bazuar në standarde kombëtare D me 35 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 3 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për një grup mund të jetë maksimalisht 20 kandidatë.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit Professional Beauty Academy, për rivalidim dhe riakreditim dhe rekomandimeve të dala nga raporti i ekipit të ekspertëve mbi rivalidimin dhe riakreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Për kualifikimin Grimer/Grimere për një vit kalendarik, lejohen (10) dhjetë grupe me nga 10 kandidatë, që në total bëjnë 100 kandidatë për një vit.

Për kualifikimin Manikyrist/ Manikyriste për një vit kalendarik, lejohen (12) dymbëdhjetë grupe me nga 10 kandidatë, që në total bëjnë 120 kandidatë për një vit.

Për kualifikimin Parukier/ Parukiere për një vit kalendarik, lejohen (3) tre grupe me nga 20 kandidatë, që në total bëjnë 60 kandidatë për një vit.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Professional Beauty Academy;
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK